

**GJYKATA KOMUNALE NË PEJË**  
**P. Nr. 560/09**

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata komunale në Pejë, trupi gjykues i përbërë nga gjykatësi i EULEX-it Gjanfranko Gallo (Gianfranco Gallo) si gjykatës kryesues, Gjykatësja e EULEX-it Verginia Miheva-Ruseva (Verginia Micheva-Ruseva) dhe gjykatësi kosovar Sadri Blakaj si anëtarë të trupit gjykues, me asistentet procesverbalmbajtëse Svetoslava Savova dhe Valentina Gashi, në rastin penal kundër të akuzuarit:

**GANI ÇEKU**, i lindur më 31 janar 1982, në Pejë, mashkull, emri i babait Gazmend, emri i vajzërisë i nënës Safete Rizaj, shqiptar i Kosovës, me vendbanim në Fushë të Pejës, i pamartuar, i gjendjes ekonomike të varfër, me shkollën e mesme të kryer, pa dënime të mehershme, në liri

I akuzuar sipas aktakuzës PP.Nr. 1487/2007, të datës 23 nëntor 2007, të depozituar në gjykatë më 27 nëntor 2007, më veprën penale si vijon:

**Lëndime të rënda trupi**, në kundërshtim me nenin 154 paragrafi 1 poka 3 e Kodit penal të Kosovës ("KPK")

Sepse:

*Në natën e 13/14 gushtit 2007, i akuzuari, zyrtar i Policisë së Kosovës, përderisa ishte në detyrë, e ndali automjetin të cilin e drejtonte pala dëmtuar, Ragip Muriqi, i cili e pengoi urdhërin e policisë të dalë nga kerri dhe pas një grindjeje, Gani Ceku e arrestoi atë, duke i shkaktuar disa lëndime në trup.*

Pasi mbajti shqyrtimet kryesore publike më 17 mars 2010, 18 mars 2010, 31 mars 2010 dhe 1 prill 2010, në praninë e:

- Të akuzuarit dhe avokatit të tij mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare, Z. Sokol Mushkolaj;
- Prokurorit publik komunal, Znjës. Lirije Morina;
- Avokatit mbrojtës të palës së dëmtuar, Mustafa Kastrati

Trupi gjykues, pas shqyrtimit vendim-marrës dhe votimit më 1 prill 2010, në bazë të nenit 391, paragrafi (1) të Kodit të procedurës penale të Kosovës (KPPK)

Më 1 prill 2010, në bazë të nenit 392 paragrafi (1) të KPPK-së, e shpall në publik dhe në prani të të akuzuarit, prokurorit publik dhe avokatit mbrojtës të palës së dëmtuar këtë aktgjykim:

## **GANI ÇEKU**

### **LIROHET**

*nga vepra penale e shkaktimit të lëndimit të rëndë trupor, në kundërshtim me nenin 154, par. 1, pika 3 të Kodit penal të Kosovës, të kryer në Pejë më 14 gushtit 2008, sepse nuk është dëshmuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale me të cilën është ngarkuar.*

### **ARSYETIM**

#### **Rrethanat procedurale**

Më 27 nëntor 2007, prokurori publik komunal i Pejës depozitoi aktakuzën PP.No.1487/2007 pranë Gjykatës komunale në Pejë kundër Gani Çekut, për shkak se kishte kryer veprën penale të lëndimit të rëndë trupor në kundërshtim me nenin 154, par. 1, pika 3 të Kodit penal të Kosovës (KPK).

Sipas aktakuzës, më 14 gusht 2007, rreth orës 00:30, në Pejë, në udhëkryqin me Urën e Zallit, polici Gani Çeku e ndali automjetin të cilin po e drejtonte pala e dëmtuar, Ragip Muriq, i cili po e drejtonte atë me shpejtësi të madhe dhe e urdhëroi atë që t'ia prezentojë

dokumentet e identifikimit. Kur pala e dëmtuar i dha ato, Çeku e goditi në dorë, e urdhëroi që të dalë nga kerri dhe kur Muriqi refuzoi, ai e hapi derën e automjetit dhe e nxori palën e dëmtuar jasht. I akuzuari pastaj ia ktheu dorën prapa shpinës duke e shtyer me forcë poshtë në asfalt me çrast i shkaktoi atij thyerje të tuberosit të madh të humerusit. Sipas aktakuzës, me këto veprime, i akuzuari e ka kryer veprën penale “të lëndimit të rëndë trupor” në kundërshtim me nenin 154, par. 1, pika 3 të Kodit penal të Kosovës (KPK).

Aktakuza u depozitua më 27 nëntor 2007 dhe u konfirmua më 13 dhjetor 2007 me aktvendimin KA.nr.96/07 të Gjykatës komunale në Pejë.

Gjykimi kryesor filloi në Gjykatën komunale të Pejës më 5 mars 2008 dhe më 12 mars 2008 u lëshua aktgjykimi P.Nr. 10/08 me të cilin i akuzuari u dënua me 120 ditë burg.

Më 9 korrik 2008, Gjykata e Qarkut të Pejës, duke vendosur mbi ankesat e të paditurit dhe të palës e dëmtuar, lëshoi aktvendimin AP.Nr. 49/08 duke i refuzuar kështu të dyja ankesat si të pabazuara.

Më 5 shtator 2008, i akuzuari depozitoi në Gjykatën komunale të Pejës kërkesë për rihapjen e procedurës penale meqenëse ishin zbuluar dëshmi të reja shfajësimi. Faktet e reja kishin të bënin me një dëshmitar të ri okular, Haki Lekajn, si dhe me ekspertizën e mjekësisë ligjore përkitazi me lëndimet të cilat i kishte pësuar pala e dëmtuar. Më 24 shtator 2008, gjykatësi kryesues i kërkoi të akuzuarit t'i sigurojë provat me të cilat do i mbështette faktet e reja, ashtu siç kërkohet me nenin 444 (2) të KPPK-së, brenda 8 ditëve. Meqenëse i akuzuari veproi tek më 9 tetor 2008, gjykata hodhi poshtë më 6 shkurt 2009, me aktvendimin KP.nr. 1/09, kërkesën për rihapje të procedurës penale, sipas nenit 445 (1) 5 të KPPK-së, mospërmbyshja e dispozitave të nenit 444 të KPPK-së.

Më 13 janar 2009, me aktvendimin P.Nr. 142/09, Gjykata e Qarkut të Pejës, duke vendosur mbi ankesën kundër aktvendimit KP.Nr.1/09 të Gjykatës komunale, e miratoi ankesën dhe lejoi rihapjen e procedurës penale duke e caktuar orarin menjëherë të rigjyimit dhe duke e pezulluar ekzekutimin e dënimit derisa aktgjykimi të bëhet i formës

së prerë. Gjykata e Qarkut ka gjetur se, në bazë të nenit 403 (1) 1 të KPPK-së, ka pasur shkelje substanciale të procedurës penale meqenëse përbërja e trupit gjykues nuk ishte në përputhje me kriteret e nenit 444, i cili parasheh se 'për kërkesën për rihapje të procedurës penale vendos trupi gjykues prej tre gjykatësve i cili ka e gjykuar lëndën në shkallën e parë në procedurën e mëparshme'.

Më 4 maj 2009, Gjykata komunale e Pejës lëshon aktvendimin KP No. 7/09 me të cilin hodhi poshtë kërkesën për rishikim në bazë të nenit 445 (2) 4 në mungesë të provave.

Më 27 korrik 2009, Gjykata e Qarkut të Pejës, me aktvendimin PN.N. Nr. 94/09, e miratoi ankesën e të paditurit kundër aktvendimit KP.Nr. 1/09, duke konsideruar se faktet e reja janë relevante dhe duhet të mirren parasysh.

Më 8 dhjetor 2009, kryetari i Asamblesë së gjykatësve të EULEX-it, duke vendosur mbi kërkesën e palës së dëmtuar për ta marrë përsipër lëndën, ia caktoi lëndën gjykatësve të EULEX-it.

### **Kompetenca e gjykatës**

Në pajtim me nenin 21 (1) të Kodit të procedurës penale të Kosovës, gjykatat komunale kanë jurisdiksion për t'i gjykuar rastet në shkallë të parë ato vepra penale të cilat janë të dënueshme me gjobë apo me burg deri në pesë vite, përveç nëse Gjykata e Qarkut ka jurisdiksion që ta gjykojë një vepër penale të tillë.

Vepra e lëndimit të rëndë trupor e paraparë me nenin 154 (1) të KPK-së është e dënueshme me burg me 6 muaj deri në pese vite: *"Kushdo që i shkakton lëndim të rëndë trupor personit tjetër ose e dëmton shëndetin e personit tjetër deri në masën e tillë sa që mund të rezultojë me [...]3) dobësimin e përkohshëm ose të madh të një organi vital ose një pjese vitale të trupit të personit tjetër [...] dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet."*

Vepra penale, sipas aktakuzës, është kryer në Pejë, dhe prandaj, sipas nenit 27 (1) të KPPK, Gjykata Komunale e Pejës ka jurisdikcion territorial që ta shqyrtojë rastin konkret.

Sipas nenit 444 (1) të KPPK, kërkesa për rihapje të procedurës penale vendoset nga trupi gjykues prej tre gjykatësve të cilët e kanë shqyrtuar lëndën në shkallën e parë në procedurën e mëparshme. Sipas nenit 420 (1)3, kur e anulon aktgjykimin, gjykata e shkallës së dytë ia kthen lëndën për rigjykim gjykatës së shkallës së parë për vendosje. Duke pasur parasysh këtë që u tha mësipër gjykatë kompetente për të vendosur rihapjen e procedurës penale është gjykata komunale në Pejë.

Vepra penale bie brenda fushë-veprimit të nenit 3(3) të Ligjit mbi jurisdikcionit për përzgjedhjen e rasteve dhe alokimit të rasteve gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, ligj ky i cili parasheh kompetencën subsidiare të gjyqtarëve të EULEX-it. Neni (3)3 parasheh, që në raste të kompetencës subsidiare, gjykatësit e EULEX-it mund ta marrin përsipër pas caktimit të lëndes nga kryetari i gjykatësve të EULEX-it. Kjo bëhet sipas kërkesës prej njëres prej palëve në procedurë ose nga kryetari i gjykatës në fjalë, dhe atë për çfarëdo arsye kur një gjë e tillë konsiderohet e nevojshme që të sigurohet administrimi i duhur i drejtësisë.

Në këtë rast, kryetari i gjykatësve të EULEX-it i ka caktuar dy gjykatës më 8 dhjetor 2009, sipas kërkesës së palës së dëmtuar me të cilën ajo kërkonte zëvendësimin e gjykatësve vendor me gjykatës të EULEX-it. Një gjykatës i Kosovës ka qenë pjesë e trupit gjykues gjatë tërë gjykimin në bazë të nenit 4.7 të Ligjit mbi jurisdikcionin. Asnjëra prej palëve nuk ka pasur kundërshtim ndaj përbërjes së trupit gjykues.

### **Shqyrtimi kryesor**

Gjykimi publik ka filluar përsëri më 17 mars 2010 dhe ka vazhduar më 18 mars 2010, 31 mars 2010 dhe 1 prill 2010 në praninë e të pandehurit Gani Çeku dhe avokatit të tij mbrojtës të caktuar sipas detyrës së tij zyrtare Sokol Mushkolaj, prokurorit publik komunal Lirije Morina dhe avokatit mbrojtës së palës së dëmtuar, Mustafa Kastrati.

Dëshmitarë të ri janë marrë në pyetje si dhe janë paraqitur dëshmi të reja. Në pajtim me nenin 15 të KPPK, përkthyesit ndërkombëtarë e kanë përkthyer procedurën gjyqësore dhe të gjitha dokumentet e rëndësishme gjyqësore të këtij gjykimi në shqip dhe anglisht, sipas nevojës.

### **Përmbledhje e dëshmive të paraqitura**

Gjykata ka dëgjuar dëshmitarët Haki Lekaj (seanca 18 mars 2010), Saud Koliq (seanca 31 mars 2010) dhe Hajdar Ahmeti (seanca 31 mars 2010). Me pëlqimin e palëve sipas nenit 368 par.1 pika 3 e KPPK gjykata i shënoi si të lexuara në procesverbal këto raporte, dokumente dhe deklarata:

- Deklaratat e dëshmitarëve : pala e dëmtuar Ragip Muriqi, Xhevat Ibraj dhe Haki Lekaj.

- Këto raportet dhe dokumente:

Formulari i përdorimit të forcës, i datës 13.08.2007, i lëshuar nga Policia e Kosovës;

Kallëzimi penal i palës së dëmtuar Ragip Muriqi, i datës 06.09.2009,

Memorandumi ndërzyrtar i Policisë së Kosovës, i datës 30.09.2007;

Raporti i komisionit për vlerësimin e përdorimit të forcës, i datës 03.10.2007;

Memorandumi ndërzyrtar i Policisë të Kosovës, i datës 04.10.2007;

Regjistri i evidencës së Policisë të Kosovës për 13.08.2007;

Dokumenti i kontrollit mjekësor i palës së dëmtuar Ragip Muriqit, 13.08.2007, Policia e Kosovës /Dr. Brahim Beqiri;

Raporti mjekësor neurologjik, i datës 15.08.2007, lëshuar nga Dr. Mithat Sh. Bala, Neuropsikiatër;

Raporti mjekësor- Ortopedist, i datës 14.08.2007, lëshuar nga Dr. Isa F. Kaliqani – Ortopedist;

Raporti mjekësor – Ortopedist, i datës 22.08.2007, lëshuar nga Dr. Isa F. Kaliqani – Ortopedist;

Raporti Mjekësor- Ortopedist, i datës 25.08.2007, lëshuar nga Dr. Bedri Bakalli – Ortopedist dhe specialist i traumave;

Raporti mjekësor, i datës 03.09.2007, lëshuar nga Fakulteti i Mjekësis/ Instituti i Forenzikës – Dr. Flamur Blakaj dhe Dr. Naim Haliti

Raporti mjekësor , i datës 27.08.2007, lëshuar nga klinika e radiologjisë dhe onkologjisë 'Rezonanca' – Dr. H. Ymeri;

Kopje e regjistrit të spitalit, i datës 14.08.2007;

Raporti mjekësor i të pandehurit Gani Ceku, i datës 13.08.2007, lëshuar nga Emergjencia/ Spitali/ Pejë;

Fotografi e lëndimeve të Gani Çekut;

Formular mjekësor mbi lëndimet e shkaktuara gjatë detyrës, i datës 13.08.2007, lëshuar nga shërbimi mjekësor i policisë së Kosovës;

Gjatë shqyrtimit janë prezantuar dëshmi të reja: raporti policor Nr 308-SHRK-2007 pregaditur nga dëshmitari Hajdar Ahmeti, i datës 8 prill 2008 në lidhje me procedurën disiplinore ndaj të pandehurit, dhe vendimi No 4-7876/07 i datës 05.09.2007 i Gjykatës për kundërvajtje në Pejë. Këto dy dokumente janë pranuar si dëshmi në gjykatë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare ka kërkuar dosjen penale të pandehurve nga Gjykata Komunale e Pejës dhe rezultati ka qenë që i pandehuri nuk ka pasur ndonjë dënim të mëparshëm.

#### **Përmbledhje e dëshmisë së dëshmitarëve**

Dëshmitari Haki Lekaj gjatë seansës së 18 marsit 2010 ka deklaruar se, në natën e 13/14 gushtit 2007, përderisa po shkonte në shtëpi, e cila gjindet përtej lumit në pejë, afër Urës së Zallit, ai ka vërejtur një patrollë policie me kerr të stacionuar në mes të rrugës si dhe policë duke ia ndërruar kahjen kerreve me qëllim ta parandalimit të tollovisë në komunikacion. Ai u afrua dhe ka parë kolegët e tij Gani Çekun, Sadat Gjogoviqin dhe Xhevat Ibrajn. Z. Lekaj ka informuar se përderisa po bisedonte me ta, një automjet VË Golf 2, i cili po vinte nga qendra e qytetit, u kthye afër urës. Gani Çeku e ndali automjetin dhe shkoi në drejtim të tij. Dëshmitari ka deklaruar se ishte tepër larg tyre për ta dëgjuar bisedën saktësisht (5-6 metra), porse ka qenë në gjendje t'i shohë ata. Ai kishte vërejtur se ata po flisnin për dokumente dhe e kishte dëgjuar Ganinë duke i thënë shoferit disa herë që të dalë nga automjeti, po personi nuk po i përmbahej urdhërit. Ai pastaj e ka parë policin duke hapur derën e kerrit duke i kërkuar shoferit që përsëri të dalë jashtë. Në

atë moment, personi e ngriti krahun e tij kah fytyra e policit kurse Gani Çeku e kapi atë për shpatull të majtë dhe kështu ndodhi një e rrahur e vogël. Një polic tjetër, Sedat Gjogoviq, ndërhyri dhe i ndihmoi Gani Çeku që ta fusin nën kontroll shoferin duke e mbështetur atë për automjet të policisë. Të dy policët ia vunë duart në pranga palës së dëmtuar dhe e vendosën në kerr të policisë. Dëshmitarit nuk i kujtohet se pala e dëmtuar a u shtri përtoke apo jo, ose se a është përdorur sprej apo jo.

**Dëshmitari Saud Koliqi**, polic ky i cili e kishte mbikqyrë procedurën disiplinore kundër Gani Çekut, u propozua si dëshmitar i të akuzuarit. Gjatë seansës më 31 mars 2010, dëshmitari ka deklaruar se nuk ka qenë i përfshirë drejtëpërdrejtë në hetimet e brendshme. Polic hetues ishte z. Hajdar Ahmeti. Sipas dëshmitarit, Gani Çeku u akuzua për tri pika, posacërisht për shkelje të nenit 135 të KPK-së, për sjellje të keqe profesionale dhe për përdorim jo të duhur të forcës. Z. Koliqi nuk ka qenë në gjendje të na japë hollësira lidhur me dëshmitarët e ekzaminuar gjatë procedurës disiplinore, meqenëse ka qenë i vetmi i cili e ka mbikqyrë hetimin. Në fund, ai ka qenë i vetmi i cili i ka dhënë komentet përfundimtare si dhe rekomandimin për veprim disiplinor. Z. Koliqi ka informuar se Gani Çeku ishte shpallur fajtor për vetëm një pikë, kryerjen e veprës penale, meqë dy pikat tjera ishin të pabazuara për shkak se nuk u dëshmuuan. Ai shpjegoi se masa disiplinore e pushimit nga puna u mor vetëm për arsye se Gani Çeku ishte shpallur fajtor nga gjykata kështu që, sipas rregullave të mbrendshme të policisë, ka qenë e obligueshme të lëshohet ndëshkim disiplinor.

Dëshmitari **Hajdar Ahmeti**, polici i cili e ka zhvilluar hetimin, gjatë seansës së 31 marsit 2010 ka dëshmuar se procedura disiplinore është iniciuar nga pala e dëmtuar, Ragip Muriqi. E tërë procedura, nga nata e parë kur kishte ndodhur incidenti e deri sa Gani Çeku u pushua nga puna, u bë nën mbikqyrje të tij. Gjatë hetimeve, ai i kishte mbledhur tërë dëshmitë relevante dhe i kishte intervistuar të gjithë dëshmitarët e përfshirë në këtë çështje, Ragip Muriqin, Visar Muriqin, Drajkovc. Isak Kaliqanin, rreshterin Halil Shalën i cili ka qenë mbikqyrës i ndërrimit atë kohë, Sedat Gjogoviqin, Xhevat Ibrajn dhe të akuzuarin Gani Çeku. Haki Lekaj nuk u mor në pyetje, meqë gjatë hetimeve asnjë dëshmitar nuk e kishte përmendur emrin e tij. Z. Ahmeti ka dëshmuar se vendimi për ta

pushuar Gani Çekun nga puna u bë vetëm në bazë të aktvendimit të Gjykatës komunale të Pejës. Sipas dëshmitarit, pushimi nga puna ka qenë i detyrueshëm për shkak të udhëzimeve të Forcës policore të Kosovës të cilat parashohin pushimin e pjestarit të forcës policore në rast se një person i tillë dënohet për shkelje të ligjit penal.

**Pala e dëmtuar Ragip Muriqi**, gjatë seansës së 5 marsit 2008, para trupit gjykues në shqyrtimin e mëprashëm, ka dëshmuar se, në natën në mes 13/14 gushtit 2007, dikund pas mesnatës, përderisa ka qenë duke e drejtuar automjetin e tij VË Golf 2, i shoqëruar nga kushëriri i tij Visar Muriqi, ai u ndal nga i akuzuari Gani Çeku i cili i kërkoi që t'i paraqesë dokumentet e identifikimit. Ai ka deklaruar se ia kishte dorëzuar dokumentet përmes dritares së hapur dhe i kishte kërkuar policisë arsyen se pse po e ndalnin në krye të rrugës e jo poshtë. Si përgjigje, Gani Çeku e kishte goditur me dorën e vet dorën e tij. Pala e dëmtuar se pasi që e kishte njoftuar të akuzuarin për drejtimin se kah po shkonte, duke e treguar këtë gjë me dorë, porse ai përsëri ishte goditur dhe i ishte urdhëruar të dalë nga automjeti. Muriqi i kishte kërkuar të akuzuarit së pari t'i verifikojë dokumentet e pastaj do të dilte jashtë. Polici i kishte thënë të dalë jashtë automjetit menjëherë dhe, në të njëjtën kohë, e kishte hapur derën e automjetit dhe kishte kapur për krahun e tij të majtë, e kishte tërhequr jashtë, ia kishte kthyer krahun prapa shpinës, e kishte goditur në bark dhe e kishte shtyer dhe shtrirë për toke. Pastaj e kishte ngritur përsëri dhe e kishte shtyrë për automjeti. Në atë moment, një polic tjetër kishte ndërhyrë në asistencë dhe e kishte kapur atë për krahun tjetër dhe të dy policët ia kishin vënë prangat në dorë. I akuzuari gjithashtu kishte përdorur sprej kundër tij. Polici pastaj e kishte vendosur atë në kerr të policisë dhe e kishin dërguar në stacion të policisë ku edhe kishte dhënë deklaratë. Përderisa ishte në kerr të policisë, i akuzuari, i cili po drejtonte kerrin, i kishte renë grusht dy herë në fytyrë. Atë natë, ai transportua në Spitalin e përgjithshëm në Pejë, por kurrfarë kontrolli mjekësor nuk ishte bërë. Ai e kishte njoftuar mjekun se kishte dhimbje të forta në shpatullën e majtë, ky i kishte rekomanduar të bëjë radiografi dhe të shkojë tek ortopedisti. Pala e dëmtuar ka thënë se e kishin mbajtur në stacionin e policisë në Istog deri në ora 08:00 e pastaj e kishin dërguar në Gjykatën për kundërvajtje në Pejë ku ishte shpallur fajtor dhe dënuar me gjobë për mospërmbushje të urdhërit të policisë dhe se e kishte drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit. Menjëherë pas asaj, ai kishte shkuar në

spital ku u ekzaminua nga Drajkovc. Isa Kaliqani, ortopedist, i cili i kishte thënë se kishte thyerje të kocit në shpatullën e majtë gjë që më vonë u konfirmua edhe me CT. Muriqi ka deklaruar se nuk e dinte se pse policia e kishte ndaluar, meqë nuk ishte i pirë dhe se nuk po e drejtonte automjetin shpejtë.

**Dëshmitari z. Xhevat Ibraj**, gjatë seansës më 5 mars 2008 para trupit gjykues në gjykimin e mëhershëm, ka deklaruar se në natën e 13/14 gushtit 2007 ai gjindej në dytërë së bashku me të akuzuarin Gani Çekun dhe Sedat Gjogoviqin dhe se automjeti i tyre ishte i parkuar tek Ura e Zallit; ai ishte duke shikuar kah Ura, Sedati ishte duke shikuar në drejtim të Rugovës, kurse i akuzuari ishte prapa tyre, në një distancë prej 2-3 metra. Nuk ka mundur ta jetë dëshmitar i momentit kur u ndalua kerri apo i bisedës në mes të akuzuarit dhe palës së dëmtuar. Ai vetëm e kishte parë të akuzuarin duke shtyrë palën e dëmtuar për kerr tijn VË Golf 21 dhe duke e bastisur. Ai ishte afruar dhe i kishte ndihmuar Gani Çekut që t'ia lidhë duart Muriqit dhe ta fusë në automjetin e policisë në mënyrë që ta çojnë për në stacion policor. Në atë moment, Ragip Muriqi ishte arrestuar, ishte paralajmëruar për arrestimin. Në stacion policor, atë e pranoi nga udhëheqësi i ndërrimit rreshteri Ali Shala i cili pastaj u mor me rastin. Sipas dijënsisë së tij, pala e dëmtuar ishte dërguar në spital atë natë për kontrollim dhe konstatimi ishte se ai gjindej në gjendje të mirë. Ishte zhvilluar test alkoholi rezultati i të cilit u tregua pozitiv. Nuk e ka vërejtur se a ka qenë pala e dëmtuar e shtrirë për toke. Nuk e dinte arsyen pse Gani Çeku veproi në atë mënyrë. Kur iu afrua palës së dëmtuar dhe pasagjerit, ai kundërmonte erë alkoholi.

Dëshmitari Visar Muriqi, kushëri dhe shok i palës së dëmtuar, gjatë seansës së 12 marsit 2008 para trupit të mëhershëm gjykues, ka deklaruar se i akuzuari Gani Çeku e kishte ndaluar atë natë dhe se Ragipit ia kishte kërkuar dokumentet. Ai gjithashtu ka deklaruar se kur Ragipi ia kishte dhënë dokumentet, i akuzuari e kishte goditur atë dy herë në dorë. I akuzuari e kishte urdhëruar Ragipin të dalë nga kerri. Kur Ragipi po dilte nga kerri, i akuzuari e kishte tërhequr për dore dhe kishte filluar ta shqelmojë dhe grushtojë duke e shtyer për toke, e kishte ngritur palën e dëmtuar nga toka dhe e kishte mbështetur për automjetin.; të dy kolegët e tij e kishin ndihmuar atë që t'ia lidhë duart Ragip Muriqit.

Visari pastaj ishte detyruar ta drejtojë automjetin e Ragip Muriqit deri tek stacioni policor. Dëshmitari ka deklaruar se ka qenë i befasuar me sjelljen e policit kur ky e kishte përdorur sprejin kundër Ragip Muriqit pala e dëmtuar arsye, sepse Ragip Muriqi nuk e kishte ofenduar apo reaguuar në asnjë mënyrë.

#### Deklarata e të akuzuarit Gani Çeku.

I akuzuari, në seansën e 31 marsit 2010, ka deklaruar se atë natë ka qenë në detyrë me Sedat Gjogoviqin dhe Xhevat Ibrajn, në udhëkryqin tek Ura e Zallit, ishte dikund mesnatë dhe, meqenëse kishte shumë komunikacion, ata po e bllokonin qasjen e automjeteve për në rrugën kryesore, kah Hotel Royali. Pala e dëmtuar Ragip Muriqi kishte bërë një kthim të shpejtë në atë udhëkryq duke vazhduar në drejtim të rrugës kryesore, në drejtim të Ho telit Royal, duke e tejkaluar automjetin e policisë i cili gjindej i parkuar në mes të rrugës. Gani Çeku ka deklaruar se e kishte ndaluar Ragip Muriqi për ta paralajmëruar për atë ndalesë të përkohshme të cilën posa e kishte thyer. Gani Çeku ishte larguar prej kolegëve të tij 5-6 metra dhe i ishte afruar kerrit të palës së dëmtuar, e kishte përshëndetur dhe ia kishte kërkuar dokumentet. Sic ka dëshmuar edhe pala e dëmtuar, edhe i akuzuari poashtu ka deklaruar se Muriqi ia kishte dorëzuar dokumentet përmes dritares së hapur duke e pyetur atë se pse po e ndalonte. Gani Çeku ka deklaruar se ati i kishte ardhë erë alkoholi kështu që e kishte urdhëruar shoferin të dalë nga automjeti. Muriqi nuk i ishte përgjigjur urdhërit duke kërkuar që së pari ai ta bënte kontrollimin e dokumenteve të tija. Gani Çeku e kishte përsëritur urdhërin duke e paralajmëruar atë se mosdëgjimi don të thotë mospërbushje e urdhërit të një personi zyrtar dhe se mund të arrestohej. Pastaj i akuzuari e kishte hapur derën e automjetit kur e kishte vërejtur se Muriqi nuk po e përmbushte urdhërin e tij duke dyshuar se mund të kishte të bënte edhe me ndonjë person i cili gjindej në posedim të drogës apo armëve. I tha shoferit të dalë nga kerri, e pastaj e preku në shpatull duke i thënë përsëri të dalë nga kerri. Muriqi doli nga kerri. I akuzuari u befasua nga një lëvizje e tillë kështu që, posa Ragip Muriqi kishte dalë nga automjeti, e kishte shtyre dhe larguar. Për shkak të kësaj shtyerjeje, pala e dëmtuar kishte rënë për toke; kur ishte ngritur, e kishte kapur Gani Çekun për gjoksi, duke ia thyer pullën e këmishës. Polici pastaj e kishte kapur Muriqin për krahun e tij të djathtë dhe ia kishte kthyer atë parap shpinës në mënyrë që t'ia lidhë duart. Si kundëreagim, Muriqi ia

kishte kapur Gani Çekun për gishtin e katërt të dorës së majtë duke ia dredhur me ç'rast i akuzuari e kishte përdorur sprejin për ta futur atë nën kontroll. Gani Çeku ka deklaruar se kolegu i tij Sedat Gjogoviqi e kishte asistuar atë gjatë vënjës së prangave në duar. I akuzuari ka pohuar se as shtyerja për automjetet e as rënja nuk ishin aq të forta sa për të shkaktuar thyerjen të cilën e kishte pësuar pala e dëmtuar. Pas kësaj, ata e kishin vendosur Muriqi në automjetin e policisë dhe dërguar në stacion policor. Në automjet, ishin tre policë (Çeku duke vozitur, Xhevat Ibraj ulur pranë tij, Sadati në ulësen prapa) kurse pala e dëmtuar ishte e ulur pranë Sadatit.

I akuzuari e kishte goditur palën e dëmtuar përderisa po shkonin për në stacionin policor. Ai gjithashtu ka thënë se se gishtin të cilin ia kishte përdredhur pala e dëmtuar ishte bërë zi dhe i fryrë për çka edhe kishte shkuar tek mjeku.

Në dy pika deklaratat e të akuzuarit dhe para trupit gjykues janë në kundërtësi me deklaratat e tij të mëhershme. Në seansën e 12 marsit 2008, i akuzuari ka deklaruar se Muriqi e kishte hapur derën e automjetit. Ai gjithashtu ka deklaruar se në e kishte kapur palën e dëmtuar për dorën e majtë duke ia kthyer prapa shpinës në mënyrë që t'ia lidhë duart, kur kolegu Sedat Gjogoviqi ia kishte marrë dorën e majtë palës së së dëmtuar dhe se të dy e kishin lidhur. Kur u pyet për këtë kundërtësi në mes të këtyre dy deklaratave, i akuzuari u përgjigj dhe sqaroi se mbetet pranë deklaratës dhënë trupit gjykues më 31 mars 2010.

## **Fjalët përfundimtare**

### Prokurori publik

Në fjalën e vet përfundimtare, Prokurorja publike e mbështeti aktakuzën në të gjitha akuzat. Sipas saj, nga të gjitha dëshmitë e administruara gjatë gjykimit kryesor, është e pakontestueshme që i akuzuari e ka kryer veprën penale të shkaktimit të lëndimeve trupore palës së dëmtuar Muriqi. Sipas prokurores, është e qartë se, meqë pala e dëmtuar ka qenë duke drejtuar automjetin shumë shpejtë, i akuzuari e kishte urdhëruar atë të dalë nga kerri dhe, kur pala e dëmtuar i paraqiti dokumentet e veta, i akuzuari e goditi atë

me dorë, e hapi derën e automjetit, e shtyu atë për automjetdhe më në fund e përdori sprejin dhe e lidhi atë. Nga këto veprime, pala e dëmtuar pësoi lëndime e, sidomos, iu thue krahu i tij i mjatë. Si përfundim, prokurortja i kërkoi gjykatës ta shpallë të akuzuarin fajtor për veprën penale me të cilën është akuzuar dhe ta dënojë atë sipas ligjit.

#### Avokati mbrojtës Mustafa Kastrati

Avokatit mbrojtës Sokol Mushkolaj, i cili mbron të akuzuarit Gani Çekun, i ka kërkuar gjykatës që ta lirojë të akuzuarit nga akuza. Ai pohoi se raportet mjeksore kanë sjëllur dyshim përkitazi me natyrën e lëndimit, duke pasur gjithashtu parasysh se Muriqi u kontrollua menjëherë me datën 13.08.2007 nga mjekët e spitalit rajonal të Pejës dhe tingëllon e çudistshme se si ata nuk e paskan vërejtur se Muriqi e kishte krahun e thyer. Së dyti, mbrojtja ka theksuar se se dëshmitari okular Sedat Gjogoviq ka munguar dhe se deklaratat e tij nuk mund gjykata t'i marrë parasysh. Së treti, ai thekson se pala e dëmtuar e ka pranuar se nuk i është përmbajtur urdhërit të policisë dhe se për këtë edhe Gjykata për kundërvajtje e kishte dënuar. Nuk ishte bërë asnjëherë ankesë në aktvendim të gjykatës. Së fundi, ai i kërkoi gjykatës ta lirojë të akuzuarin.

#### I akuzuari Gani Çeku

I akuzuari ka deklaruar se mbetet pranë fjalës përfundimtare të avokatit të tij mbrojtës

#### **Konstatimet faktike dhe ligjore**

Duke i vlerësuar të gjitha provat e administruara, trupi gjykues konsideron se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale të lëndimit të rëndë trupor (neni 154, par. 1 pika 3 të e Kodit të procedurës penale të Kosovës).

Nga dëshmia e palës së dëmtuar dhe e dëshmitarëve si dhe nga deklarata e të akuzuarit mund të konsiderohet si e pakontestueshme kjo që vijon:

Në natën e 12/13 gushtit 2007, i akuzuari Gani Çeku, polic i Kosovës, ka qenë pjesë e patrullës policore e cila ka qenë duke e mbikqyrë komunikacionin në qendër të Pejës, së bashku me Sadat Gjogoviqin dhe dëshmitarin Xhevat Ibraj. Ata e kanë ndalur qasjen e automjeteve në drejtim të Hotelir Royal me ç'rast e kanë parkuar atomjetin e tyre

kujdestar në mes të rrugës. Kah ora 00:30h më 13 gusht , pala e dëmtuar Ragip Muriqi ka qenë duke e drejtuar automjetin e vet VË Golf 2 dhe përveç tij në automjet ishte edhe nje i kushëri i tij dhe shok, dëshmitari Visar Muriqi. Pala e dëmtuar është afruar më shpejtësi tek vendi ku këta tre policë kishin qenë të pozicionuar dhe e tejkaloi automjetin e policisë duke shkuar në drejtim të Hotelir Royal. I akuzuari Ceku e ka ndalur automjetin VË Golf 2 të cilin e drejtonte Ragip Muriqi dhe ia ka kërkuar dokumentet e identifikimit. Muriqi, pasi ka bërë komente lidhur me vendin se ku është ndalur, i ka dorëzuar dokumentet. I akuzuari ka vërejtur se shoferit po i vinte era alkohol dhe i ka kërkuar që të dalë nga kerri. Shoferi ka refuzuar duke i kërkuar policit që së pari t' i kontrollojë dokumentet.

Rrjedha e ngjarjeve të mëtutjeshme është përkshkruar në mënyra kundërthënëse nga pala e dëmtuar në njërën anë, dhe nga i akuzuari në anën tjetër. Kështu deklaratat e dëshmitarëve mund të ndahen në dy grupe varësisht nga fakti se cilën me cilën palë ishte dëshmitari.

Sipas palës së dëmtuar dhe dëshmitarit Visar Muriqi, i akuzuari e ka hapur derën e automjetit dhe e kishte kapur karhun e tij të majtë, e ka tërhequr jashtë, ia ka kthyer dorën dhe vendosur prapa shpine, e ka goditur në bark dhe e ka shtrirë për toke. Pastaj e ka ngritur dhe e ka shtyrë për automjet. Në atë moment, një polic tjetër ka intervenuar për t'i ndihmuar atij duke e kapur në krahun tjetër dhe të dy policët ia kanë vu prangat. Në duar. Sipas Muriqit, ai nuk e ofenduar të pakuzuarin. E sa i përket alkoholit, ai shpjegon se e ka pirë një birrë me shokun e vet dëshmitarin Muriqi dhe se nuk ka qenë i pirë as pak.

Sipas të akuzuarit Çeku, ky e ka përsëritur urdhërin edhe dy herë dhe meqë u refuzua përsëri, e ka hapur derën e automjetit dhe e ka informuar shoferin se mund të arrestohet nëse nuk i përmbahet urdhërit zyrtar. Kur u ndodh jasht kerrit, për shkak të lëvizjes së tij të shpejtë, Muriqi u shtye nga Gani Çeku dhe ra për toke. Sipas Çekut, ky nuk e ka shtyer atë rëndë por pala e dëmtuar ishte jostabile për shkak të ndikimit të alkoolit. Pastaj Muriqi është ngritur dhe e ka kapur Gani Çekun për gjoksi dhe si rezultat i kësaj pulla e këmishës së të akuzuarit u hoq. Gani Çeku e ka marrë dorën e tij të djathtë dhe ia ka vënë pas shpinës në mënyrë që t'ia vëjë prangat por nuk mundi meqenëse Muriqi ia

kishte kapur atij gishtin e katërt të dorës së majtë dhe ia ka dredhur. Në atë moment, Gani Çeku e ka përdorur sprejin kundër Muriqit, e ka mbështetur për kerri me qëllim që t'ia lidhë duart. Dy policët tjerë iu kanë afruar dhe i kanë ndihmuar Gani Çekut që t'ia lidhin duart Muriqit.

Deklarata e Haki Lekajt e mbështet verzionin e të akuzuarit: sipas tij, Gani Çeku e ka hapur derën e automjetit VË Golf 2, e ka kapur Muriqin për shpatull të majtë, e pastaj ka ndodhur një rrahje e shkurtër dhe Sedat Gogoviqi ka intervenuar dhe ata të dytë ia vunë prangat Muriqit.

Dëshmitari Xhevat Ibraj, polic ky tjetër i cili gjindej në vendin e ngjarjes, e ka parë Gani Çekun duke e mbështetur Muriqin për automjeti dhe se i ka ndihmuar Gani Çekut t'ia lidhë duart atij.

Për ta shqyrtuar hollësisht këtë ngjarje, gjykata duhet t'i marrë gjithashtu parasysh edhe ngjarjet pasi që palës dëmtuar i ishin vënë prangat.

Së pari, është e pakontestueshme që policët e kanë vendosur Ragip Muriqin në kerr të policisë dhe e kanë dërguar në stacion të policisë. Në ora 00:58 më 13.08.2007, policët e kanë thirrë policin kujdestar gjatë cilës thirrje është inçizuar ky mesazh “ Po vijmë ka stacioni policisë me një person të arrestuar për shkak të mospërbushjes së urdhërit dhe sulmit mbi personin zyrtar”.

I akuzuari ka paraqitur raport mbi përdorimin e forcës me anë të sprejit OC mbi kryesin e veprës Muriqin. Në atë raport e ka dhënë këtë sqarim: “ *Përderisa isha në detyrë me kolegët e mi, rreshterin Xhevat Ibrën dhe Sedat Gjogoviqin, sulmuesi i lartëpërmendur (Ragip Muriqi), pas mos nënshtrimit ndaj urdhërit të personit zyrtar dhe për shkak se në atë moment dyshohej pse ishte nën ndikim të alkoholit. Pas disa urdhërave që iu dhanë në mënyrë të vazhdueshme për të dalë nga automjeti i tij, i njëjti nuk iu nënshtrua urdhërit. Në momentin kur deshi të dalë nga kerri, provoi të më godasë për unë iu shmanga duke e shtyer me dorën kryesore, kur sulmuesi edhe u rrëzua. Në momentin kur shkova me*

*kolegët e mi për t'ia vënë prangat, ai më kapi për këmishë timën duke e kapur pullën e metalët të këmishës dhe prëri ka tentuar të më godasë, por pa sukses. Përderisa mundohesha ta mbajt nën kontroll atë, i dyshuari arriti ta kapë gishtin e parafundit të dorës së majtë. Duke e parë përgaditjen e tij fizike edhe pse ne ishim tre kolegë, nuk ishte mundur që ta fusim nën kontroll duke e përdorur forcën e butë me duar të zbrazëta. Në momentin kur i dyshuari e dëmtoi gishtin tim, dhe për këtë kam edhe raport mjksor, menjëherë e kam vlerësuar dhe e kam parë të arsyeshme ta përdori sprejin duke u munduar që ta përdor në sasi të vogël, vetëm sa për ta futur të dyshuarin nën kontroll. Pas përdorimit të sprejit, ne menjëherë e futëm të dyshuarin nën kontroll dhe e arrstuam.”*

Gjatë natës së 13.08.2007 në ora 04:45 Muriqi u mor në pyetje në shërbimin policor të Kosovës në Pejë dhe në bazë të fletës të kontrollit mjksor Nr. 9052, nuk ka pasur shenja evidente të lëndimeve, diagnoza e përcaktuar ka qenë “Contusio corporis” (lëndim i trupit).

Më 14.08.2007, pala e dëmtuar u ekzaminua nga një ortopedist i cili e ka përcaktuar si diagnozë “ contusion pars cervicalis vertebrae, Regioscapulae dex at dorsi” ( lëndim në pjesën e qafës dhe spatull prapa prapa shpinës). Pacienti u udhëzua që të bëjë ekazimini radiografie si dhe të marrë ilaçe kundër dhimbjes.

Më 15.08.2007, Ragip Muriqi u ekzaminua nga neuropsikiatri. Sipas raportit, doktori specialist ka konstatuar se Muriqi ishte goditur me shkop në krahun e tij të djathtë, në qafë dhe dhe shpinë dhe diagnoza ishte “Sy carvico-cehvalicae posttraumatic” (post trauma në qafë dhe kokë). Ky specialist ka kërkuar që të bëhet kontrolli i radiografisë.

Më 22.08.2007, Muriqi përsëri u ekzaminua nga ortopedisti i cili i shkroi marrje të ilaçeve për dhimbje dhe që të ketë ditë pushimi.

Më 25.08.2007, Muriqi u ekzaminua nga specialisti ordopedist dhe i traumatologjisë të cilët e udhëzuan të marrë dy javë ditë pushim si dhe ilaçe.

Më 27.08.2007, pas një ekziminimi tomografik, u konstatua thyerje e humerusit të madh në anën e majtë me zhvendosje të vogël.

Më 03.09.2007, me kërkesë të veten Muriqi u ekzaminua nga një komision i përbërë nga dy mjekë të Fakultetit të mjeksisë, Instituti i mjeksisë ligjore në Prishtinë. Në bazë të ekzaminimit mjeksor që u cek më sipër, komisioni konkludoi se lëndimet e përshkruara – thyerja e tuberculum majus (tuberosit të madh) të humerusit të majtë, lëndimi i indeve të buta të pjesën e pelvisit të anës së djathtë, të shkaktuar nga një akt mekanik të një mjeti të fortë dhe të rëndë, të gjitha janë pjesë e lëndimit të rëndë trupor.

I akuzuari Gani Çeku u ekzaminua më 13.08.2007 nga qendra e ndihmës së parë në Pejë dhe u konstatua se ai kishte marrë lëndim në gishtin e katër të dorës së majtë. Më 13.08.2007, Gani Çeku mori një ditë pushimi mjeksor.

Më 03.10.2007, një komision i caktuar e ka bërë vlerësimin e përdorimit të forcës (spreji OC) nga i akuzuari. Sipas konkludimit, Gani Çeku kishte përdorur forcë në pajtim me udhëzimin e parimit për përdorimin e forcës.

Më 06.09.2007, pala e dëmtuar ka bërë kallëzim penal tek prokurori publik kundër të akuzuarit për shkaktim të lëndimeve trupore. Ai gjithashtu ka depozituar ankesë edhe në PK. Kundër Gani Çekut u inicua procedurë penale si dhe procedurë disiplinore. Si rrjedhojë, ai u pushua nga puna.

Me aktgjykimin e datës 14.08.2007 të Gjykatës për kundërvajtje të Pejës, Ragip Muriqi u shpall fajtor sepse më 13.08.2007 kah ora 02:10 afër Urës së Zallit në Pejë, ai ishte duke e drejtuar automjetin Golf nën ndikim të alkoholit-1.38% alkohol në gjak.

Pas rezultateve të ekziminimeve mjeksore të palës së dëmtuar dhe të akuzuarit e sidomos duke pasur parasysh se Muriqi kishte marrë lëndime në shpatullën e majtë dhe të djathtë, në shpinë si dhe në anën e djathtë rreth pelvisit kurse Gani Çeku në gishtin e dorës së

majtë si dhe i mungonte një pullë në këmishën e tij të punës, mund të konkludohet se në mes të akuzuarit dhe palës së dëmtuar ka pasur rrahje ose së paku zënkë e vogël.

Të dytë e konfirmojnë se i akuzuari e ka shtyer Muriqin i cili kishte rënë për tokë me shpinë. Ky fakt gjithashtu përforcohet me lëndimet e diagnostifikuara gjatë ekzaminimit të parë mjeksor të zhvilluar mbi palën e dëmtuar në ditën e incidentit.

Egzaminimi i mëvonshëm mjeksor e ka specifikuar se këto lëndime kanë qenë në pjesën e qafës dhe të kokës. Kurrëfare lëndimesh nuk janë gjetur në pjesën e përparme të trupit të Muriqit, pa marrë parasysh verzionin të cilin e ka dhënë pala e dëmtuar, sipas të cilit i akuzuari gjithashtu e kishte goditur atë dhe i kishte rënë grusht përderisa ai ishte i shtrirë përtoke dhe më në fund e kishte goditur me shqelma në barkun e tij.

Prandaj kjo pjesë e verzionit të tij nuk është e mbështetur në dëshmi objektive. Kjo tregon disa dyshime në verzionin e tij të fakteve. Përmëteper lëndimet të cilat i ka pësuar i akuzuari tregojnë se pala e dëmtuar ka provuar ta sulmojë atë. Gjithashtu është e pakontestueshme në bazë të dëshmive të prezentuara se i akuzuari e ka përdorur sprejin OC dhe se së paku dy policë- i akuzuari dhe njëri prej kolegëve të tij- është dashur të intervenojnë në mënyrë që të ia lidhin duart Muriqit duke e shtyer atë për automjeti: kjo tregon qartë se pala e dëmtuar ka reaguar dhunshëm ndaj veprimeve të policëve.

Sipas prokurorit, i akuzuari i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore Muriqit duke ia thyer *tuberculum maius-in* e tij të *humerues-it* të majtë dhe gjithashtu ka shkaktuar lëndime të lehta në pjesën e shpatullës së djathtë, duke tërhequr palën e dëmtuar nga automjeti duke ia kthyer krahun e tij prapa shpine dhe duke e shtyer atë dhunshëm në asfalt.

Sic dihet mirë *humerus-i* është ashti i pjesës së sipërme të krahut që shtrihet nga shpatulla deri te brryli. Tuberosi i madhë i *humerus-it* gjendet në pjesën anësore të kokës së humerusit dhe pjesës poshtme anësore të tuberosit të vogël.

Sipas nenit 154, paragrafi 1- i.3 të KPK-së, ai i cili shkakton dëm trupor mbi personin tjetër apo i bënë dëm shëndetit të personit tjetër në atë masë sa që e dëmton përkohësisht

apo qenësisht organin vital apo ndonjë pjesë vitale të personit tjetër dënohet me burg prej 6 muajve deri në 5 vite.

Vepra penale e shkakimit të lëndimit trupor mund të kryhet në dy mënyra duke e lënduar dikend apo duke e dëmtuar seriozisht shëndetin e tij. Lëndimi trupor është lëndim i integritetit fizik dhe përfshin çfarëdo ndarje, shkatërrim apo dëmtim të ndonjë pjese të trupit njerëzor. Dëmtimi i shëndetit së pari është akt i shkakimit të ndonjë sëmundje fizike apo mendore, në mënyrë të përhershme apo të përkohshme.

Thyrja e *tuberculum majusit* ( tuberozit të madhë) të *humerusit* të majtë është lëndim i rëndë trupor i cili në mënyrë të përkohshme e dobëson krahun e majtë të trupit njerëzor.

Është konstatuar se pala e dëmtuar e ka pësuar këtë lloj lëndimi. Nga trupi gjykues pritet të përgjigjet në pyetjen se i akuzuari a i ka shkakuar lëndim Ragip Muriqit natën kritike.

Së pari dhe çfarë është më e rëndësishmja, vlen të ceket se prokurori nuk e ka dëshmuar se thyrjen që u përmend më lartë a e ka shkakuar me të vërtetë i akuzuari në natën e incidentit apo jo.

Në fakt, thyrja e *tuberkulum majusit* (tuberozit të madhë) në *humerus-in* e majtë është diagnostifikuar tek me 27.8.2007, 14 ditë pas natës kritike. Ka dyshime se, edhe pse pala e dëmtuar është egzaminuar menjëherë pas arrestimit si dhe në ditët që kanë vijuar, doktorët nuk kanë diagnostifikuar ndonjë lëndim në *humersu-in* e majtë.

Deri me 27.08.2007 gjithë doktorët të cilët e kanë egzaminuar palën e dëmtuar kanë konstatuar lëndime në pjesën e qafës, kokës, dhe të shpatullës por askush nuk ka gjetur thyrje të humerusit.

Prandaj duhet të thuhet përsëri se nuk është e sigurt se kur pala e dëmtuar e ka pësuar thyrjen e cekur dhe se a ka ndodhur kjo në natën e incidentit apo më pastaj: me fjalë të tjera distanca kohore në mes të zënkës me policin dhe diagnozës së parë të thyrjes është

tepër e gjatë për të arritur tek siguria ku mund të pohoet, përtej dyshimit të arsyeshëm se thyrja është shkaku nga veprimet e të akuzuarit natën e incidentit.

Përmëtepër mendimi i komisionit mjekësor i datës 03.09.2007 nuk përgjigjet në pyetjen se a është thyrja e *tuberkulum majusit* (tuberozit të madhë) të *humerusit* të majtë të palës së dëmtuar rezultat i veprimeve dhe sjelljes të akuzuarit kundër Muriqit. Sa i përket kësaj pike, vlen të ceket se mendimi është dhënë në bazë të kërkesës së palës së dëmtuar duke marr parasysh vetëm rrethanat dhe faktet të cilat i ka dhënë Muriqi (shiko raportin mjekësor nr.80 data 3 shtator 2007).

Prandaj nga dëshmit e paraqitura në shqyrtimin kryesor nuk mund të bëhet vlerësimi se thyrja a ka ndodhur në natën e incidentit a më vonë. Lidhur me këtë pikë nëse nuk është e kontestueshme se i akuzuari e ka shtyer palën e dëmtuar për tokë, në anën tjetër nuk janë paraqitur dëshmi solide se i akuzuari ja ka thyer atij dorën kur ai ra përtoke. Përkundrazi dëshmit cojnë kah një konkludim tjetër sipas së cilit mendohet se, pasi që i akuzuari ka rënë përtoke, ai ka qenë në gjendje të reagojë dhe të rrahët me policin. Duket se krahët atij i punonin si duhet nëse ka qenë në gjendje të filloj rrahjen dhe ta detyroj policin që ta përdor sprejin me qëllim të qetësimit të tij.

Gjithashtu është e mundshme se thyrja është shkaktuar nga dredhja e krahut të palës së dëmtuar momentin kur policët ja kanë lidhur duartë atij dhe arrestuar atë, meqë veprimi i ashpër bile dhe i dhunshëm i cili është dashur për të ia lidhur duart një personi rezistues dhe të papërshtatshëm, mund të ketë qenë shkak i një lëndimi të tillë, sidoqoftë në anën tjetër, duhet përsëritur se është e dyshimtë se lëndimi është zbuluar tek dy javë ditë pas incidentit. Kështu që duhet të konkludohet se nuk ka prova të mjaftueshme sa i përket egzistencës së thyrjes në momentin e incidentit.

Përmëtepër bile edhe nëse supozojmë se thyrjen e ka shkaktuar veprimi i policit natën e incidentit, duhet thënë se sjellja e tij bje brenda-për-brenda dispozitës së mbrojtjes së nevojshme.

Në fakt argumenti është gjithashtu valid kur është fjala dhe për lëndimet tjera të lehta të cilat i ka psuar Muriqi (lëndime këto të cilat për dallim nga thyrja janë gjetur mu në natën e arrestimit- ndrydhja e indeve të buta në zonën e shpatullës, zonën e shpinës dhe në zonën e pelvisit të anës së djathtë), vlen të ceket se, në bazë të asaj çfarë kanë deklaruar shumica e dëshmitarve okularë, në mes të akuzuarit dhe palës së dëmtuar ka pasur një lloj grindjeje. Këtë rrethanë e përforcon fakti se edhe polici është lënduar.

Prandaj meqenëse ka pasur reagim të dhunshëm të palës së dëmtuar ndaj urdhërit të ligjshëm të cilin e ka dhënë polici, duhet pranohet dhe merret parasysh se i akuzuari ka reaguar në mbrojtje të nevojshme ashtu siq e parasheh neni 8, i KPK-së.

Në fakt mund të pohohet me mjaftë siguri se lëndimet e mësipërme janë kryer nga i akuzuari gjersa ai po jipte kundërpërgjigje ndaj veprimit të dhunshëm nga pala e dëmtuar “i cili faktikisht e ka lënduar të akuzuarin”. Rrethana se lëndimet e cekura mësipër nuk ishin aq serioze (dhe absolutisht në përputhje me veprimin e shpejt dhe të dhunshëm të një arrestimi me dhunë) i përgjigjet në mënyrë të përkryer parimit të proporcionalitetit të cilin e parasheh neni 8, paragrafi 2 i KPK-së.

E kemi thënë tashmë se dispozita e mbrojtjes së nevojshme e merr parasysh vlerësimin se a është legjitim apo jo veprimi i të akuzuarit momentin kur e ka ndaluar apo arrestuar palën e dëmtuar.

Sa i përket kësaj çështjeje, vlen të përkujtohet se, sipas ligjit mbi trafikun, pjesëmarrësit në trafik janë të detyruar ti respektojnë rregullat e trafikut, shenjat e trafikut të vendosura në rrugë si dhe shenjat dhe urdhërat e një personi të autorizuar.

Siq e kanë deklaruar edhe pala e dëmtuar edhe i akuzuari, ishte pala e dëmtuar ajo e cila e ka shkelur rregullën e përkohshme të vendosur nga patrulla dhe kjo ishte arsyea pse ajo u ndalua me plotë të drejtë. Në bazë të nenit 20 të ligjit mbi qetësin dhe rendin publik, “ *me 30 ditë burg do të dënohet për kundërvajtje (...) ai i cili nuk vepron në pajtim me urdhërin e personit zyrtarë, kompetentë për ndalimin e lëvizjes, prezencës apo qëndrimit në një*

*vend të caktuar në kushtet ku paqja dhe rendi publik si dhe siguria janë në rrezik ose nëse egziston mundësia që paqja dhe rendi publik mund të rrezikohen*". Është e pakontestueshme se Gani Ceku ka qenë person i autorizuar zyrtar meqënëse ka qenë polic dhe se si pjesëtar i patrullës policore me detyrë të mbikqyrjes dhe kontrollit publik ka qenë kompetent për ta ndaluar automjetin të cilin e drejtonte pala e dëmtuar.

Në bazë të nenit 298 (1) të KPK, "*kushdo që drejton një automjet me motor përderisa është i intoksikuar me alkohol apo substanca tjera intoksikuese dhe, si rezultat, shihet se nuk është në gjendje të drejtoj automjetin me siguri duke rrëzuar kështu trafikun publik, jetën njerëzore, sigurinë fizike apo pronën në një shkallë të madhe dënohet me burg deri me 3 vite*" ( Rrezikimi i trafikut publik gjersa i intoksikuar).

Është vlerësuar se gjatë kontrollimit Ceku e ka vërejtur se shoferi po kundërmonte alkohol dhe për këtë e kishte urdhëruar atë që të dal nga kerri. Duke pasur parasysh se drejtimi i automjetit nën ndikim të alkoholit është qartë i ndaluar nga ligji i Kosovës, urdhëri i të akuzuarit ka qenë qartë i ligjshëm.

Sipas nenit 210 të KPPK-së, "*nëse ndonjë person kapet gjatë aktit të kryerjes së veprës penale e cila ndiqet penalisht ex-officio ose ai person përcillet, policia ose ndonjë person tjetër janë të autorizuar ta arrestojnë atë përkohësisht bile edhe pa ndonjë urdhër gjyqësor*". Drejtimi i automjetit nën ndikim të alkoholit është vepër penale dhe si e tillë mund të qoj kah arrestimi i ligjshëm në bazë të nenit që u përmend mësipër. Përëteper, mos përmbushja e urdhërit policor është kundërvajtje sipas nenit 226, 1,25 sipas LSBRM-së.

Është konstatuar se pas kryerjes së testit të alkoholit në stacionin policor se Ragip Muriqi ka pasur shkallën e intoksikimit me alkohon 1.38%. Përvec kësaj Muriqi është shpallur fajtor dhe dënuar me gjobë dhe nga gjykata për kundërvajtje e Pejës, me aktgjykimet nr. Regj. 4-7876/07 dhe 4-7875/07 të 14 gushtit 2007 për të dyjat vepra, edhe drejtim të automjetit nën ndikim të alkoholit si dhe për mos-përmbushje të urdhërit policor. Prandaj gjykata beson se urdhëri i të akuzuarit i dhënë palës së dëmtuar që të dal nga kerri dhe vendimi i tij i pasues për ta arrestuar atë pas zënkës kanë qenë të dyja legjitime kështu që sjellja e tij pas reagimit të dhunshëm të palës së dëmtuar mund të konsiderohet se bie në

sferën e mbrojtjes së nevojshme. Meqënëse reagimi i palës së dëmtuar ka qenë i paligjshëm.

Në përfundim, parim themelor në ligin penal i cili parashihet me nenin 3, paragrafi 1 të KPK-së në pajtim me nenin 6 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut është ai i prezumimit të pafajsisë: sipas këtij parimi barra e provave i bie prokurorisë. Prokuroria nuk iu është përmbajtur këtij detyrimi meqënëse dyshimi se thyrja nuk është shkaktuar nga veprimi i të akuzuarit ende mbetet pezull edhe pas përfundimit të gjykimit kryesor.

Për këto arsye, gjykata konsideron pikësëpari se nuk ka dëshmi të qarta se thyrja e *humerusit* ka ndodhur natën e incidentit.

Së dyti, edhe nëse thyrja ka ndodhur natën e incidentit, ai lëndim dhe lëndimet tjera më të lehta janë shkaktuar nga i akuzuari në mbrojtje të nevojshme për shkak të reagimit të paligjshëm të cilin e kishte bërë pala e dëmtuar, prandaj i akuzuari nuk mund të konsiderohet përgjegjës për lëndimet që u përmendën më sipër.

### **Shpenzimet e procedurës penale**

Shpenzimet i bart gjykata pas lirimit të akuzuarit sipas nenit 103 paragrafit 1 të KPPK-së.

Procesverbal mbajtëse  
Valentina Gashi

Kryetari i trupit gjykues  
Gianfranco Gallo



Gjykatëse raportuese  
Verginia Micheva- Ruseva

**Këshillë juridike:**

Personat e autorizuar mund të depozitojnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi nëpërmjet Gjykatës së Qarkut të Pejës për Gjykatën Supreme të Kosovës brenda 15 ditëve nga data e pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi.